

Raporti Transparencës 2014

Përditësuar

Maj 2015



Përmbajtje

Mbi raportin e transparencës 2014	3
Struktura ligjore, pronësia dhe marrëveshjet e rrjetit	4
Organet drejtuese	5
Standardet dhe cilësia e sistemit të kontrollit të brendshëm	6
Kontrollet e cilësisë në PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.....	9
Praktikat e pavarësisë	9
Edukim i vazhdueshëm	12
Shoqëritë e audituara	13
Informacioni financiar	14
<i>Kontakte</i>	<i>15</i>



Mbi raportin e transparencës 2014

Ky raport publikohet në përputhje me kërkesat e Nenit 45 të Ligjit Nr. 10091 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të ekspertit kontabël të regjistruar dhe të kontabilistit të miratuar” në Republikën e Shqipërisë.

Raporti në vijim është i zbatueshëm për vitin financiar 2014.

Në PwC, ne jemi të angazhuar për të vendosur në praktikë parimin e transparencës.

Për të bërë realitet këtë angazhim dhe për t’ju paraqitur më shumë qartësi palëve të interesuara, në mënyrë të vazhdueshme rishikojmë mënyrat sesi ne punojmë, përshkruajmë veten dhe komunikojmë si brenda shoqërisë ashtu edhe jashtë saj.

Nga këndvështrimi ynë, faktorët kyç të cilët e dallojnë PwC midis organizatave kryesore botërore të shërbimeve profesionale janë shkalla e shtrirjes së rrjetit të PwC dhe standardet me të cilat firmat e PwC kanë rënë dakord që tu përmbahen. Këto standarde mbulojnë fusha të rëndësishme të tilla si pavarësia dhe menaxhimi i riskut, menaxhimi i kapitalit njerëzor, marka dhe komunikimet.

Firmat PwC kanë rënë dakord të ndjekin standardet e rrjetit dhe të jenë subjekt i rishikimeve periodike. Pajtueshmëria e firmave PwC me standardet e rrjetit monitorohet rregullisht.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k, një nga shoqëritë e rrjetit global të PricewaterhouseCoopers (PwC), i nënshtrohet të njëjtave procedura si gjithë firmat e tjera të rrjetit.

Në këtë raport, ne po ndajmë disa detaje në lidhje me strukturën ligjore dhe pronësinë, organizimin e rrjetit të PwC, përshkrimin e strukturës drejtuese, standardeve dhe proceseve, duke përfshirë informacione specifike në lidhje me pavarësinë, shpërblimin dhe arsimimin e vazhdueshëm.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k., Rr. Ibrahim Rugova, Nr. 5 Sky Tower, kati 9/1, Tiranë, Shqipëri
T: +355 (4) 2242 254, F: +355 (4) 2241 639, www.pwc.com/al



Struktura ligjore, pronësia dhe marrëveshjet e rrjetit

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k është shoqëri me përgjegjësi të kufizuar e formuar në përputhje me dispozitat e Ligjit nr. 9901 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”.

Kapitali i shoqërisë zotërohet nga Znj. Laureta Këlliçi në masën 51% dhe nga PricewaterhouseCoopers Eastern Europe BV e cila është një shoqëri pjesë e rrjetit global të PwC e themeluar në Holandë, në masën 49%.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k është pjesë e rrjetit PwC ashtu si PricewaterhouseCoopers Eastern Europe BV.

Marrëveshjet e rrjetit dhe firmat anëtare

Si pjesë e rrjetit PwC, PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k është një njësi ligjore e veçantë ashtu si çdo firmë e rrjetit PwC. Në shumicën e vendeve të botës, e drejta për të praktikuar auditim dhe kontabilitet i lejohe vetëm firmave kombëtare që janë të zotëruara për pjesën më të madhe nga profesionistë vendas të kualifikuar. PwC është një rrjet global i firmave anëtare të veçanta, të zotëruara dhe që operojnë lokalisht në vende të ndryshme përreth botës. Firmat PwC janë anëtare të PricewaterhouseCoopers International Limited dhe kanë të drejtën që të përdorin emrin e PricewaterhouseCoopers.

Rrjeti u siguron firmave anëtare bazat për të ndarë njohuritë, aftësitë dhe burimet, duke bërë të mundur që firmat e PwC të punojnë bashkë për të siguruar në mënyrë të vazhdueshme shërbime të një cilësie të lartë në shkallë globale ndaj klientëve ndërkombëtarë dhe lokalë ndërkohë që vazhdojnë të operojnë si biznese lokale.

PricewaterhouseCoopers International Limited

PricewaterhouseCoopers International Limited (PwCIL) është një shoqëri private britanike me përgjegjësi të kufizuar. PwCIL nuk praktikon kontabilitet, nuk u siguron shërbime klientëve dhe nuk bën biznes me palë të treta. Përkundrazi, qëllimi i saj është të veprojë si një entitet koordinues për firmat PwC në rrjetin global PwC. PwCIL punon për të zhvilluar dhe zbatuar politika dhe iniciativa të cilat krijojnë një trajtim të



përbashkët dhe të koordinuar për firmat PwC, aty ku është e përshtatshme. PwCIL fokusohet në fushat kyç si strategjia, marka, risku dhe cilësia.

Organet drejtuese

Struktura drejtuese e PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

Shoqëria administrohet nga Z. Paul Tobin dhe Z. Jock Nunan, ortakë të PricewaterhouseCoopers dhe përgjegjës për firmat e rrjetit të PwC në Europën juglindore si dhe nga Znj. Laureta Këlliçi, Ekspert Kontabël i Regjistruar në Shqipëri.

Pjesë e shoqërisë janë tre Ekspertë Kontabël të Regjistruar pranë Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar në Republikën e Shqipërisë:

- Znj. Laureta Këlliçi
- Z. Jonid Lamllari ACCA
- Znj. Enida Cara ACCA

Departamenti i auditimit dhe shërbimeve të tjera të sigurisë udhëhiqet nga **Jerina Annie Gjollma**, që mban pozicionin e Drejtoreshës së departamentit. Znj. Gjollma mban një licencë të audituesëve të certifikuar në Kanada (CPA, CA) si dhe është anëtare me të drejta të plota e Shoqatës së Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Audituesve të Kosovës (ShKÇAK).

Drejtimi dhe politikat drejtuese të PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k janë të bashkërenduara me rrjetin e PwC në Europën qendrore dhe lindore dhe me rrjetin global të PwC.

PwC në Europën Qendrore dhe Lindore

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k është pjesë e grupimit të shoqërive anëtare të rrjetit global të PwC për Europën Lindore dhe Qendrore (PwC Central and Eastern Europe – CEE).

Ky grupim është një sistem matricor i drejtimit ku çdo ortak apo partner ka të drejtën për të votuar çdo katër vjet për Drejtorin Ekzekutiv dhe Bordin Drejtues i cili përbëhet nga Drejtorë Ekzekutiv dhe Operacional nga shoqëritë e ndryshme anëtare të PwC CEE ku bën pjesë edhe PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.



Bordi është përgjegjës për të përcaktuar objektivat e biznesit në nivel grupi (PwC CEE) dhe për të siguruar që të gjitha shoqëritë pjesë e grupimit PwC CEE janë gjatë gjithë kohës në përputhshmëri të plotë me politikat ndërkombëtare që zbatohen nga firmat anëtare të rrjetit të PwC.

Bordi Drejtues i PwC CEE përbëhet nga pesë anëtarë.

Bordi Global

Bordi ka përgjegjësi për qeverisjen e PwCIL, mbikëqyrjen e Ekipit Udhëheqës të Rrjetit dhe miratimin e standardeve të rrjetit. Bordi nuk ka rol të jashtëm. Anëtarët e Bordit zgjidhen nga partnerët e gjithë firmave PwC në çdo katër vjet, me bordin aktual i cili e ka filluar punën në Prill 2013.

Ekipi Udhëheqës i Rrjetit

Ekipi Udhëheqës i Rrjetit përcakton strategjinë e përgjithshme për rrjetin PwC dhe standardet për të cilat firmat pajtohen që të përmbahen.

Këshilli i Strategjisë

Këshilli i Strategjisë, i cili përbëhet nga liderët e firmave më të mëdha PwC, përshtat ndryshimet në drejtimin strategjik të rrjetit dhe lehtëson shtrirjen e tyre në ekzekutimin e strategjisë.

Ekipi Ekzekutiv i Rrjetit

Ekipi Ekzekutiv i Rrjetit raporton tek Ekipi Udhëheqës i Rrjetit dhe koordinon linjat kryesore të shërbimit dhe zona funksionale të tilla si Risku dhe Cilësia, Kapitali Human, Operacionet, Marka dhe Komunikimi në të gjithë Rrjetin PwC.

Standardet dhe cilësia e sistemit të kontrollit të brendshëm

Anëtarësimi në rrjetin PwC varet nga zbatimi i standardeve të përbashkëta nga një firmë. Çdo firmë PwC është përgjegjëse për rrezikun e vet dhe cilësinë e punës dhe, kur është e nevojshme për zhvillimin e përmirësimeve. Për të mbështetur transparencën dhe qëndrueshmërinë, çdo anëtar i firmës nëpërmjet partnerit të territorit nënshkruan një



konfirmim vjetor të përputhshmërisë me standardet e përcaktuara. Siç u tha më lart, këto mbulojnë një gamë të gjerë fushash, duke përfshirë pavarësinë, etikën dhe sjelljen e biznesit, auditimin, këshillimin dhe menaxhimin fiskal, qeverisjen, politikat anti-ryshfet dhe mbrojtjen e të dhënave dhe privatësinë.

Ka disa procese të përbashkëta për të ndihmuar firmat PwC të zbatojnë standardet.

Elementet kryesore përfshijnë:

- Mënyrën sesi ne bëjmë biznes
- Kulturën e qëndrueshme
- Politikat e cilësisë dhe proceset
- Kontrollat e cilësisë

Mënyra sesi ne bëjmë biznes

Firmat e PwC ndërmarrin aktivitetet e tyre të biznesit në kuadër të zbatimit të standardeve profesionale, ligjet, rregulloret dhe politikat e brendshme. Këto plotësohen nga një Kod Etike dhe Sjellje Biznesi për partnerët dhe stafin.

Kapitali njerëzor i PwC ka detyrim të dijë, të kuptojë dhe të jetë në përputhje me udhëzimet e përfshira në këtë kod, si dhe vlerat (Përsosmëri, Puna në grup dhe Udhëheqja) në të cilën janë bazuar udhëzimet e tij.

Kulturë e qëndrueshme

Për të promovuar suksesin e vazhdueshëm të biznesit, firmat PwC ushqejnë një kulturë që mbështet dhe inkurajon punonjësit e PwC që të sillen në mënyrë të përshtatshme dhe etike, sidomos kur ata marrin vendime të vështira. Punonjësit e PwC kanë qasje të drejtpërdrejtë në një rrjet të gjerë mbështetës brenda firmave të tyre përkatëse – në mënyrë formale dhe joformale, specialistë dhe teknik për të ndihmuar ata të arrijnë zgjidhje të përshtatshme. Ekziston edhe një kulturë e skepticizmit, e objektivitetit profesional dhe bashkëpunimit mes firmave, si dhe konsultimi të cilat të gjitha së bashku mbështesin këtë kulturë.

Politikat e cilësisë dhe proceset

Çdo firmë PwC ka politika të bazuara në standardet e rrjetit PwC. Gjithë firmat PwC kanë qasje në metodologjitë e përbashkëta dhe materialet mbështetëse për gjithë

shërbimet që ato ofrojnë. Këto metodologji dhe materiale janë të ndërtuara për të ndihmuar partnerët e firmave dhe stafin e tyre për të kryer punën e tyre në mënyrë të qëndrueshme, dhe për të mbështetur zbatimin e tyre në funksion të përmbushjes së standardeve dhe mënyrës se si PwC bën biznes. Çdo udhëheqës i një angazhimi është përgjegjës për caktimin e partnerit dhe stafit çdo angazhim të veçantë dhe për ndërtimin e kombinimit të duhur të kompetencës profesionale dhe të përvojës.

Kontrollet e cilësisë

Çdo firmë PwC është përgjegjëse për monitorimin e efektivitetit të cilësisë së sistemeve të kontrollit të saj. Kjo përfshin kryerjen e një vetë-vlerësimi të sistemeve të saj dhe të procedurave dhe kryerjen apo ndërmarrjen e aktiviteteve në lidhje me të - kontrolle të pavarura për angazhimet individuale. Përveç kësaj, PwC CEE dhe PwCIL monitoron pajtueshmërinë e rrjetit të firmave me standardet e rrjetit dhe ato profesionale. Kjo përfshin monitorimin nëse çdo firmë PwC kryen kontrolle objektive të kontrollit të cilësisë dhe kontrolle të angazhimit në përputhje me rregulloren dhe proceset e vendosura. Në mënyrë periodike, organet drejtuese të PwC CEE, kryejnë kontrolle të pavarura të cilësisë së firmave anëtare të saj.

Standardi përkatës në saj të të cilit kryhen kontrolle të cilësisë është Standardi Ndërkombëtar për Kontrollin e Cilësisë 1: 'Kontrolli i cilësisë për firmat që kryejnë auditime dhe rishikime të pasqyrave financiare dhe angazhime të tjera të sigurisë dhe të shërbimeve të lidhura' ('SNKC 1').

Përveç sa më sipër, çdo partner i PwC është subjekt i rishikimit në nivel angazhimi të paktën një herë çdo tre vjet. Ky rishikim përfshin rishikimin e detajuar të praktikës së auditimit për angazhime të veçanta. Qëllimi është kontrolli për përmbushjen e standardeve të rrjetit PwC nga ana e çdo partneri në çdo angazhim për sa i përket procedurave të detajuara të tij.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k i nënshtrohet edhe kontrolleve periodike që kryhen nga Instituti i Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike.

Qëllimi thelbësor i programit të rishikimit të cilësisë është të vlerësojë për çdo firmë PwC që:

- sistemet e menaxhimit të cilësisë janë efektive dhe në përputhje me standardet e rrjetit,

- angazhimet e përzgjedhura për rishikim janë kryer në përputhje me standardet profesionale dhe kërkesat e auditivit/shërbimeve të tjera të PwC,
- rreziqet janë identifikuar dhe menaxhuar në mënyrë të përshtatshme.

Kontrollet e cilësisë në PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k

Kontrollet e cilësisë së kryera në mënyrë të pavarur nga PwC CEE janë të vazhdueshme për PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k ashtu si për çdo firmë tjetër anëtare. Kontrolli i cilësisë i ushtruar nga PwC CEE në lidhje me procedurat e ndjekura nga PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Në vitin 2011, 2013 dhe 2014 janë kryer përkatësisht kontrolle nga ana e Institutit të Ekspertëve Kontabël të Autorizuar dhe Bordi i Mbikëqyrjes Publike duke u bazuar në praktikat e auditimit të përzgjedhura për vitet 2010, 2011, 2012 dhe 2013. Këto kontrolle kanë pasur vlerësime maksimale për PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k.

Praktikat e pavarësisë

Politika

Audituesit duhet të jenë objektiv në çdo aspekt të punës së tyre. Pavarësia është thelbi i këtij objektiviteti dhe ka dy elemente: pavarësia e mendjes dhe pavarësia e shfaqur. PwC i përforcon këto elementë përmes një kombinimi duke vendosur theksin e duhur duke filluar nga strukturat më të larta drejtuese, konsultime të pavarura mbi çështje që kërkojnë gjykim, trajnime të vazhdueshme si dhe vëzhgim i kujdesshëm i kërkesave mbi pavarësinë.

Politika Globale mbi Pavarësinë e PwC – bazuar në Kodin e Etikës për Profesionin e Kontabilistit sipas Bordit të Etikës së Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilistëve - përmban minimumin e standardeve me të cilat firmat PwC kanë rënë dakord për t'i përmbushur, përfshirë procese për ruajtjen e pavarësisë nga klientët kur është e nevojshme. Firmat PwC vendosin kufizime dhe procese shtesë sipas rregullave lokale dhe kërkesave etike. Detajet mbi kërkesa të tilla me efekt jashtë vendit komunikohen përmes rrjetit.

PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k, ashtu si gjithë shoqëritë e tjera të rrjetit, ka implementuar një sistem për programin dhe monitorimin e pavarësisë i cili konsiston në:

1. Politikat dhe procedurat e shkruara
2. Një sistem automatik i vëzhgimit për njësitë ekonomike të cilave mund tu ofrohen shërbime të kufizuara bazuar në standardet ndërkombëtare të etikës
3. Trajnimi i vazhdueshëm për pavarësinë
4. Monitorim i brendshëm i sistemeve dhe kontrolleve të pavarësisë
5. Përgjegjësia për pavarësinë që i caktohet drejtuesve
6. Një kulturë e përshtatshme që fokusohet në përcaktimin e përgjegjësisë duke filluar nga strukturat kryesore
7. Raportim i menjëhershëm i negociatave të punësimit të stafit me klientë të shoqërisë
8. Raportimi i stafit në lidhje me shkelje të mundshme të pavarësisë
9. Politikat dhe proceset e disiplinës
10. Kontrolli mbi marrëdhëniet e biznesit dhe komisionet apo tarifat e kushtëzuara

Në kuadër të përmbushjes së standardeve ndërkombëtare të etikës dhe pavarësisë, PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k ka krijuar dhe monitoron sistemet e kontrollit për të arritur përmbushjen e kriterëve të mëposhtme:

1. Përgjegjësia e drejtimit dhe cilësia brenda shoqërisë
2. Kërkesat etike
3. Procedurat për pranimin dhe vazhdimësinë e marrëdhënieve me klientët dhe angazhimet specifike
4. Burimet njerëzore
5. Kryerja e angazhimit
6. Monitorimi

Trajnimi

Modulet e trajnimit mbi Politikën e Pavarësisë Globale PwC si dhe tema të lidhura janë dorëzuar nga të gjitha firmat PwC. Ata plotësojnë këto materiale trajnimi me përmbajtje shtesë të përshtatura për të reflektuar kërkesat e tyre lokale. Linjat e shërbimit si Angazhimet e Auditimit dhe Sigurisë, Tatime dhe Këshillimi Financiar gjithashtu sigurojnë trajnime dhe materiale të tjera që lidhen me parashikime mbi shërbimet



jashtë sigurimit dhe marrëdhëniet e biznesit. Të sapo ardhurit trajnohen mbi Politikën e Pavarësisë Globale PwC pavarësisht se nga cila pjesë e praktikës bashkohen.

Pajtueshmëria

Proceset e pajtueshmërisë bazohen në një kombinim të aktivitetit të biznesit dhe sistemeve të monitorimit.

Firmave PwC u kërkohet të sigurohen me autorizimin nga partneri drejtues i angazhimit në lidhje me parashikimet për shërbimet jashtë auditimit – dhe në disa raste – për shërbimet e auditimit mbi firmat në “Listën e Pavarësisë”. Autorizimi jepet vetëm pas një analize të kujdesshme nëse shërbimi mund të dëmtojë pavarësinë e firmës raportuese.

Partnerëve dhe menaxherëve, të cilët përballen me klientët në të gjitha firmat PwC, u kërkohet të regjistrojnë detajet mbi portofolat e investimit në një bazë të dhënash konfidenciale që siguron monitorimin e investimeve në kohë reale të mbajtura përkundrejt ‘Listës së Pavarësisë’ të letrave me vlerë të palejuara. Marrëdhëniet e bizneseve të bashkuara duhet të aprovohen, regjistrohen dhe monitorohen rregullisht.

Përveç këtyre dhe sistemeve të tjera të monitorimit të pajtueshmërisë, firmat PwC kryejnë një numër të gjerë procesesh konfirmimi dhe verifikimi duke përfshirë:

- konfirmime vjetore mbi përputhshmërinë, dhe
- inspektive dhe programe testimi mbi përputhshmërinë.

Shkeljet

Firmat PwC duhet të kenë politika disiplinore dhe mekanizma për të promovuar pajtimin me politikat dhe proceset e pavarësisë, si dhe duhet të raportojnë dhe adresojnë çdo shkelje të kërkesave të rrjetit PwC.



Edukim i vazhdueshëm

Qëllimi i PwC për mësim dhe edukim (M & E) është të sigurojë qasje kundrejt një programi të gjerë kursesh të zhvilluara në përputhje me standardet globale, ndërkohë gjithashtu t'ju sigurojë mbështetje udhëheqjes së firmave të PwC -së dhe duke nxitur përgjegjësi personale për edukim të vazhdueshëm.

Firmat e PwC janë të angazhuara për dorëzimin e auditimeve me cilësi në të gjithë botën. Për t'i ndihmuar ata për këtë, ju jepet një mësim i qëndrueshëm praktikuesve së tyre për auditimin, si dhe specialistëve në Këshillim dhe Taks të cilët sigurojnë mbështetje gjatë auditimit, qasje në kurse që mbulojnë mjetet e auditimit të PwC –së, të rehat mbi standardet e auditimit dhe të kontabilitetit dhe implikimet e tyre, fushat e riskut të auditimit dhe cilësi në angazhime. Kurset zhvillohen duke përdorur teknikat e mësimi më të praktikuara të dizajnuara për të përmbushur nevojat e praktikuesve.

Zgjedhjet tona për trajnim janë të ndërtuara për të zhvilluar gjykimin profesional, skepticizmin dhe përsosmërinë teknike dhe profesionale për të arritur cilësinë në çdo gjë që bëjmë. Ka shumë programe të fokusuara për njerëzit me role të veçanta ose që ju shërbejnë klientëve me karakteristika unike. Këta individë përfshijnë Partnerë të Kontrolleve të Cilësisë; njerëz që udhëheqin auditime shumëkombëshe ose angazhime me qendra shërbimi të përbashkëta, dhe persona që ju shërbejnë klientëve rreth globit që janë të listuar në bursat amerikane. Fokusi ynë vitin e kaluar ka qenë për të vazhduar dhe rritur e zhvilluar kurrikulat tona në përgjigje të nevojave që kemi identifikuar midis praktikuesve tanë.

Megjithatë, përveç fokusimit në “çfarë” njerëzit tanë mësojnë, është po aq e rëndësishme për tu marrë në konsideratë “si” ata e bëjnë këtë. Një pjesë e madhe e qasjes së mësimi vjen nga përvoja në punë. Një pjesë tjetër e rëndësishme vjen nga të mësuarit nga të tjerët, qoftë duke marrë dhe duke diskutuar reagimet, ose duke vëzhguar dhe duke punuar me të tjerët, me modele, apo me trajnerë dhe mentorë. Pjesa tjetër vjen nga të mësuarit formal. Zgjidhjet tona mësimore formale ndryshojnë në metodë që nga mësimet nëpërmjet internetit deri në kurset në klasë që ju japin praktikuesve mundësinë për të zhvilluar gjykimin e tyre profesional duke ndarë njohuritë dhe përvojat e tyre me instruktorët e tyre dhe kolegët.

Së bashku me 169,000 njerëz në të gjithë firmat e PwC-së, detyra për edukim të vazhdueshëm gjatë karrierës së gjithë secilit është një sfidë e madhe. Mekanizma në të gjitha nivelet si individ, firmë dhe rrjet , janë vënë në lëvizje për të ndihmuar në arritjen



e këtij qëllimi. Udhëheqësit e M&E të PwC –së janë përgjegjës për raportimin e planeve të tyre për trajnimet e vitit dhe , në fund të vitit, shpërndarjen e trajnimeve aktuale në audiencën e synuar për çdo program.

Shoqëritë e audituara

Gjatë vitit 2014, PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k ka kryer auditimin ligjor të 2 bankave që kryejnë veprimtarinë e tyre në Republikën e Shqipërisë (2013: 4, 2012: 3, 2011: 4, 2010: 3, 2009: 3).

Shoqëria ka kryer auditimin e pasqyrave financiare të një grupi, shoqëritë e të cilit kryejnë veprimtarinë në tregun e sigurimeve gjatë këtij viti duke përfshirë aktivitetet e jetës dhe jo-jetës si dhe të një shoqërie sigurimesh individuale.

Asnjë nga shoqëritë e audituara nga PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k nuk ka të listuar kapitalin e vetë në bursën kombëtare apo në ato ndërkombëtare.

Shoqëria	Aktiviteti
Raiffeisen Bank sh.a. (grupi)	Bankë dhe aktivitete te tjera financiare
Veneto Banka sh.a.	Bankë
Sigal Uniqa Group Austria sh.a. (grupi)	Sigurime dhe aktivitete te tjera financiare
Eurosig sh.a.	Sigurime



Informacioni financiar

Ndarja e të ardhurave të PricewaterhouseCoopers Audit sh.p.k për vitin 2014 është si në vijim:

Shërbimi	Të ardhurat në mijë Lek
	2014
Auditimi ligjor	90,259
Shërbime të tjera shërbime sigurie	443
Shërbime të tjera konsulence	89,972
Totali	180,674

Kontakte

Laureta Këllici
Annie Gjollma

PwC Audit sh.p.k.
Rr. Ibrahim Rugova,
Sky Tower, Kati 9/1,
Tiranë, Shqipëri

Telefon: +[355] (42) 242 254 / 280 423
Faks: +[355] (42) 241 639

